



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:155921

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05852753

Ac.nr.7925/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.B, kundër të paditurit M.A nga fshati Sh....., Komuna e L....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.S, avokat në Lipjan, për shkak të kthimit të mjeteve, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.363/17 të datës 22.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit M.A nga fshati Sh....., Komuna e L....., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.363/17 të datës 22.04.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.363/17 të datës 22.04.2021, ka vendosur: *“I APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, si e BAZUAR dhe DETYROHET i padituri M.A nga fsh, Sh....., K. L....., përfitues në masën bletari dhe prodhim, përpunim dhe tregtim i mjaltit nga programi i vitit 2014, që shumën prej 3,257.88 €, t`ia kthejë në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës nr., me kamatë ligjore 8%, duke llogaritur nga dita kur është marrë ky aktgjykim e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. II. Detyrohet i padituri që kësaj gjykate t`ia*

kompensojë shpenzimet e procedurës në emër të taksës gjyqësore për padi dhe atë në shumë prej 40 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.”

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar, si dhe paditësit ti njihen shpenzimet e procedurës siç i ka kërkuar në fjalën përfundimtare dhe shpenzimet për ankesë dhe taksës për ankesë në shumë prej 196 € apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësja ka paraqitur përgjigje në ankesë duke i kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurit me propozim që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 04.08.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, për shkak të kthimit të mjeteve, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.363/17 të datës 22.04.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruar ka gjetur se nuk ka qenë kontestuese se paditësja e kishte mbështetur të paditurin në financimin për programin e zhvillimit rural për masën për bletari dhe prodhim/përpunim dhe tregtim të mjaltit, pasi që në mes të palëve ndërgjyqëse ishte lidhur kontratë në bazë të së cilës paditësja e ka financuar projektin e lartcekur të të paditurit në shumën prej 3,637 € apo 65% nga vlera totale e pranueshme e projektit të financuar prej 5,596 €. Kontestuese mes palëve ishte kthimi i mjeteve të lartcekura financiare, pasi që paditësja kishte pretenduar se këto mjete nuk janë përdorur sipas qëllimit të kontratës, ndërsa i padituri ka pretenduar se nuk është përgjegjës për kthimin e mjeteve, pasi që pajisjet të cilat i kishte subvencionuar paditësja, i ka shitur për shkak të një sëmundje të bletëve në fund të vitit 2016, fillim i vitit 2017. Në bazë të provave të administruara, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, për faktin se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është provuar përgjegjësia e të paditurit, në kuptim të nenit 5 par. 2 të kontratës, ku keqpërdorimi i të paditurit është konstatuar nga raporti i dt. 14.02.2017 i inspektorëve të AZHB-së, andaj në rastin konkret edhe vetë i padituri e ka pranuar faktin se i ka shitur pajisjet e marra në bazë të projektit për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural i vitit

2014, nga cka rezulton se i padituri nuk i ka përmbushur objektivat e kontratës, në kuptim të nenin 1.4 të kontratës, ku nga raporti i inspektorëve janë përshkruar mjetet të cilat mungojnë tek i padituritë cilat i janë dhënë si mbështetje për bletari. Andaj gjykata e ka detyruar të paditurin që paditëses t'ia kthej shumën prej 3,257.88 €uro, të marra sipas kontratës për investime, detyrimeve të së cilës i padituri iu është shmangur, duke vlerësuar se paditëses i ka shkaktuar dëm në lartësinë e gjykuar.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të të paditurit por që gjeti se të njëjtat nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe, nga ajo sic është vendosur në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase kjo gjykatë konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në lidhshmëri me këtë gjykata ka dhënë shpjegime për mënyrën se si i ka vlerësuar provat, mënyrën se si i ka kualifikuar faktet e çështjes në pajtim me normat materialo-juridike dhe si i ka zbatuar normat materialo-juridike në përputhje me gjendjen faktike, ku aktgjykimi i atakuar është përpiluar në përputhje me nenin 160 par. 4 dhe 5 të LPK-së.

Nuk janë pranuar pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se nga gjendja e vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë është zbatuar drejtë e drejta materiale, ashtu që nga provat e administruara konkretisht Raporti i kontrollit i dt. 14.02.2017, rezulton se pajisjet për zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e mjaltit nuk janë gjetur te i padituri gjatë inspektimit në terren, e poashtu edhe i padituri vetë e ka pohuar se të gjitha i ka shitur, andaj sipas nenit 1.4 të Kontratës për financim e dt. 11.07.2014 parashihet se *“përfituesi është i obliguar të respektojë tërësisht kushtet gjatë implementimit dhe tri vjet pasi të bëhet pagesa e fundit”*, ndërsa sipas nenit 5.2 të kësaj kontrate parashihet se *“në qoftë se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë vëren se investimi publik i financuar nuk është përdorur sipas qëllimit të tyre, planit teknik të projektit dhe planit të biznesit ose është shitur ose dhënë më qira, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka të drejtë dhe obligim që të kërkoj kthimin e shpenzimeve të bëra.*

Prandaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses është i drejtë dhe i argumentuar. Me dispozitën e nenit 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve shprehimisht parashihet se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin*

detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, ndërsa me dispozitën e nenit 136 të të njëjti ligj është përcaktuar: “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompenzoj përveq nese vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.

Në kuptim të dispozitave të cituara e duke u mbështetur në fakte përcaktuese të provuara me mjete provuese të besueshme për bazën e kërkesëpadsisë dhe për lartësinë e saj, rezulton se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e cituara ligjore. Ashtu siç ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, qëndrimin juridik të saj lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, për faktin se i padituri në cilësi të fermerit ka aplikuar për subvencione për vitin 2014 dhe nga paditësja ka marrë subvencione, siç rezulton nga shkresat e lëndës, i padituri nuk i është përmbajtur obligimeve kontraktuese për të cilat është subvencionuar, pajisjet për bletari i ka shitur, andaj i ka shkatiuar dëm paditëses për shkak të mospërmbushjes së konhtratës, në lartësinë siç e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se kamata prej 8% është gjykuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, që kamata prej 8% është kamatëvonesë dhe gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se pala e paditur ka rënë në vonesë nga momenti i vendosjes (marrjes së aktgjykimit), kur kërkesa për kamatë është bërë e arritshme, andaj vendimi i gjykatës së shkallës së parë është në përputhshmëri të plotë me dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7925/21 më datë 19.06.2024

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca Dula d.v.